



Breaking News:

Tiranë/Njoftim

⏏ ⏪ ⏩



Lajmet

24/10/2024

Peqin – Plagosi Me Armë Zjarri Një Shtetas, Policia Identifikon Autorin Dhe Vijon Puna Për Kapjen E Tij

Peqin

Plagosi me armë zjarri një shtetas, Policia identifikon autorin dhe vijon puna për kapjen e tij.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Peqin, pas marrjes se njoftimit se në spitalin e Peqinit, është dërguar për mjekim, i plagosur në këmbë dyshohet me armë zjarri shtetasi Sh. C., rreth 41 vjeç, banues në Peqin, menjëherë kanë organizuar punën për identifikimin dhe kapjen e autorit të dyshuar.

Si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore të kryera nga strukturat për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Peqin në bashkëpunim me shërbimet e Sektorit për Hetimin e Krimeve të Rënda të DVP Elbasan u bë identifikimi i autorit të dyshuar të ngjarjes, shtetasi A. T, 26 vjeç, i cili dyshohet se gjatë një konflikti për motive të dobëta, rreth orës 21:10, në lagjen “Xhami” Peqin, ka plagosur me armë zjarri në këmbë, shtetasin Sh. C., rreth 41 vjeç.

Shtetasi Sh. C., ndodhet në kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën.

Vijon puna për kapjen e autorit të dyshuar.

Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për zbardhjen e rrethanave dhe dokumentimin ligjor të rastit

◀ Raporti i ngjarjeve, 24 tetor 2024

Bulqizë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Dushaj”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve ▶

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

▼

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)